




Planuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivety	14.11.2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHUK	6967/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1168/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1168/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesi

_____ në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1168/2023 të datës 18.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Anullohet vendimi Nr.73/2023 i datës 24.08.2023 i nxjerrë nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

III. Obligohet Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik që në afat prej 15 ditëve nga marrja e këtij vendimi të ndërmarrë veprimet adekuate administrative me qëllim të zbatimit të pikës II të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit (në tekstin në vijim-Ankuesi) i punësuar sipas shkresës së Emërimit me numër 02/Nr.21/96 të datës 23.08.2011 në pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" në Komunën e Shtimes, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik përmes vendimit Nr.73/2023 të datës 24.08.2023 i ka pezulluar certifikatën profesionale të prokurimit për një periudhë njëvjeçare.

Ankuesi kundër këtij vendimi më datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6131/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, ndërsa Këshilli me datë 11.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, më datë 27.10.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendim për zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6131/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i KRPP me numër protokollit 73/2023 i datës 24.08.2023; Shkresë emërimi i M.H. i datës 24.08.2011; Ankesë e kompanisë Edona shpk e datës 19.10.2022; Raporti i ekspertit shqyrtues me numër protokollit 562/22 i datës 04.11.2022; Njoftim për dhënie të kontratës i datës 09.12.2022; Certifikatë nga IKAP për me numër 302 e vitit 2013; Certifikatë e avancuar profesionale për prokurim e me numër 202 e vitit 2020; Certifikatë e avancuar profesionale për prokurim e M.H. me numër 257 e vitit 2017-2019; Njoftim për përfundim të projekteve i datës 24.11.2022; E-mail nga M.R. për Q.A. etj. i datës 06.12.2022; E-mail nga M.R. për Q.A. etj. i datës 01.12.2022; Kërkesa për pushim e M.H. i datës 09.12.2022; Kontratë pune Drejtoria e Prokurimit me numër nr.03/1/2019 i datës 12.12.2022; Kërkesë për informim nga OSHP; E-mail i datës 10.01.2023; Vendim i KRPP me numër protokollit 45/2022 i datës 25.10.2022; Vendim i KRPP me numër protokollit 11/2021 i datës 24.02.2021; Vendim i OSHP me numër protokollit 562/22 i datës 25.01.2023; Letërnjoftim i M.H.; Autorizim nga M.H. për avokat i datës 08.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 11.10.2023; Kërkesë nga OSHP për marrje masash ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit të autoritetit kontraktues të Komunës së Shtimes i datës 24.08.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm kolegji i këshillit) bazuar në shkresat e lëndës konstaton se ankuesi ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil i konfirmuar përmes shkresës së emërimit 02/Nr.21/96 të datës 23.08.2011 të Komunës së Shtimes dhe se i njëjti mbanë pozitën e Udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit në Komunën e Shtimes, dhe se mbi këtë bazë konfirmohet kompetenca lëndore për vendimmarrje nga këshilli në lidhje me objektin e kësaj ankese gjithnjë duke ju referuar nenit 101 (Shërbimi Civil) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me paragrafin 2 i cili parasheh: "2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.....", dhe Ligjin Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) i cili në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 parasheh: "1.1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil", poashtu kjo kompetencë lëndore derivon edhe nga Ligji i cili ishte në fuqi në kohën e dorëzimit të ankesës në këshill e që ndërlidhet me objektin e kësaj ankese përkatësisht Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë i cili në nenin 24 paragrafi 3 në lidhje me të drejtën për informim dhe ankimim parasheh: "3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji.....", poashtu e drejta e ankesës në këshill nga ana e nëpunësve civil parashihet edhe në Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik përkatësisht nenin 16 ndërlidhur me të drejtën e ankesës e cila dispozitë parasheh: "çdo nëpunësi civil në pajtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik mund të paraqesë ankesë në KPMSHC brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data kur pala është e njoftuar me vendimin për masën disiplinore". E drejta e ankesës në këshill nga ana e ankuesit është e paraparë edhe me dispozitat e nenit 101 Paragrafi 1 të Rregullores 001/2022 të nxjerrë nga Bordi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik e cila rregullore në nenin 101 paragrafi 1 të kësaj sa i përket drejtës së ankesës së nëpunësve civil në lidhje me vendimet e bordit të KRPP-së parasheh: ".1 Zyrtari i Prokurimit i pakënaqur me vendimin e Bordit të KRPP-së, ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit për vendimin, nëse i njëjti është shërbyes civil".

Andaj ndërlidhur me dispozitat e potencuara si më lartë konstatohet kompetenca lëndore e këshillit në lidhje me objektin e kësaj ankese andaj edhe më poshtë do të trajtojmë në mënyrë të hollësishme pretendimet e ankuesit në lidhje me objektin e kësaj ankese, gjithnjë referuar dispozitave të Ligjit të aplikuar të Zyrtarëve Publik që ishte në fuqi në këtë periudhë si dhe legjislacionit të veçantë që ndërlidhet me objektin e kësaj ankese.

Kolegji i këshillit nga shkresat e lëndës konstaton se ankuesi kundër vendimit Nr.73/2023 të datës 24/08/2023 të nxjerrë nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6131/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi nga ky organ kemi shkelje të dispozitave procedurale, konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet dhe që ky vendim i atakuar përmes kësaj ankese të anulohet.

Ndërsa nga përgjigja e datës 11.10.2023 të pranuar në këshill në të njëjtën datë nga organi përkatësisht Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik që atakohet përmes kësaj ankese, konfirmohet nga i njëjti organ se ka mbetur pranë qëndrimeve të pasqyruara në vendimin Nr.73/2023 të datës 24/08/2023 të nxjerrë nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 18.09.2023.

Kolegji i këshillit duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimi Nr.73/2023 të datës 24/08/2023 të nxjerrë nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 18.09.2023 të atakuar përmes kësaj ankese, konstaton faktin se i njëjti është nxjerrë bazuar në dispozitat e nenit 25 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L/237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 (LPP), lidhur me trajtimin kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (në tekstin e mëtejshëm -OSHP-), për marrjen e masave për zyrtarin përgjegjës të prokurimit publik të autoritetit kontraktues-Komuna e Shtimes, dhe se ankuesit përmes vendimit të atakuar përmes kësaj ankese i është shqiptuar masa e pezullimit të certifikatës profesionale të prokurimit për një periudhë njëvjeçare për faktin se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të legjislacionit të prokurimit publik.

Kolegji i këshillit referuar pretendimit të ankuesit sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale të parapara me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me rastin e vendimmarrjes mori për bazë dispozitat e këtij ligji përkatësisht dispozitat si më poshtë, nenin 6 paragrafi 1,2 dhe 3, Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit: "1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit. 2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse. 3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit, nenin 7 paragrafi 1 dhe 2, Parimi i objektivitetit dhe paanësisë: "1. Organi publik duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme. 2. Veprimet e zyrtarit publik nuk duhet të ndikohen nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor, politik apo nga presioni politik, nenin 8 paragrafi 1 dhe 2, Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme: "1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme", dhe konstaton se bazuar në provat e ofruara nga ankuesi përkatësisht vendimi Nr.45/2022 i datës 25.10.2022 i KRPP-së dhe Vendimi Nr.11/2021 i datës 24.02.2021, që konfirmojnë shkelje ligjore të dispozitave materiale dhe procedurale që rregullojnë fushën e prokurimit publik, ndërsa për shkelje afërsisht të njëjta nga organi i njëjtë ndaj tyre janë shqiptuar masa të ndryshme përkundër propozimeve për anulim të certifikatës profesionale në dy rastet, por se me rastin e vendimmarrjes ishin marrë parasysh rrethanat lehtësuese si dhe këto shkelje afërsisht të njëjta nuk ishin cilësuar si shkelje esenciale-të rënda të legjislacionit të prokurimit publik nga i njëjti organ që ka nxjerrë vendimin e atakuar me këtë ankesë, përkatësisht në rastin konkretë përkundër që ankuesi më herët nuk kishte pasur ndonjë vërejtje të shqiptuar nga KRPP-ja, poashtu nga ankuesi nuk kishte nënshkruar as kontratën nga se të njëjtën më datë 12.12.2023 e kishte nënshkruar zyrtarja F.R, nga se ankuesi nga data 09.12.2022 deri më datë 16.12.2022 ishte në pushim mjekësore, andaj mbi këtë bazë dhe bazuar në dispozitat e LPP-së kolegji i këshillit konstaton se vendimi i atakuar me këtë ankesë bie ndeshë

me këto dispozita të potencuara si më lartë dhe në këtë kuptim pretendimi për shkelje të dispozitave procedurale është i bazuar.

Kolegji i këshillit duke vlerësuar pretendimin sa i përket konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike në lidhje me vendimin e atakuar, ku kishte deklaruar se: *"KRPP-ja me rastin e nxjerrjes së vendimit kishte konstatuar se bazuar në faktet dhe rrethanat lidhur me këtë lëndë komisioni ka konstatuar se zyrtari përgjegjës i prokurimit (në tekstin e mëtejshëm ZPP) pas pranimit të ekspertizës nga Eksperti Shqyrtues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit pa pranuar një vendim përfundimtarë të Panelit Shqyrtues më datë 08.11.2022 ka themeluar komision të ri për rivlerësim",* kolegji i këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës përkatësisht përmbajtjes së vendimit të atakuar në faqen 2, ku i njëjti i referohet Autoritetit Kontraktues që ka themeluar komisionin e ri të rivlerësimit, e që në këtë rast nënkupton Zyrtari Kryesor Administrativë e jo ankuesit përkatësisht ZPP-ja, andaj në kontekst të këtyre dispozitave pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit në lidhje me konstatim të gabuar të gjendjes faktike sa i përket çështjes së konstatimit të KRPP-së, i cili sipas pretendimit të ankuesit në këtë vendim kishte konstatuar se: *"ZPP-ja (ankuesi) ka vazhduar me procedurat e dhënies së kontratës duke publikuar njoftimin për dhënie të kontratës dhe duke nënshkruar kontratën më datë 12.12.2022",* kolegji i këshillit konstaton se bazuar në vendimin e atakuar përkatësisht në faqen 2, në lidhje me çështjen e vazhdimin të procedurës së rivlerësimit, publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës dhe nënshkrimin e të njëjtës i referohet si autoritet kompetentë Autoritetit Kontraktues-AK, e jo ZPP-së si zyrtarë përgjegjës, dhe në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji i këshillit konstaton se KRPP-ja me rastin e vendimmarrjes përkatësisht pezullimin e certifikatës profesionale të prokurimit publik për një periudhë 1 vjeçare ndaj ankuesit përveç që nuk ka marrë për bazë çështjen e cenimit të marrëdhënies së punës sa i përket pozitës që e ushtron me aktemrim, nuk ka marrë parasysh edhe faktin se ky proces kishte të bënte me një proces të tenderimit që ka të bëjë me grantin e performancës që ndërlidhet me rregullimin e parkut në fshatin Davidoc, e që ishte interes publik i komunitetit dhe që kishte afatin e fundit të realizimit të këtij projekti datën 12.12.2022, rrethanë e konfirmuar nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal përmes shkresës së datës 21.11.2022 drejtuar Kryetarit të Komunës së Shtimes, si dhe faktin se nga ankuesi nuk ishte nënshkruar kjo kontratë, poashtu përmes vendimit të OSHP-së-PSH.nr.562/2022 pika II kishte lënë në fuqi kontratën e nënshkruar më datë 12.12.2022 pikërisht duke u bazuar në interesin publikë, në këtë formë duke konfirmuar faktin se në procesin e rivlerësimit të këtij procesi ishin zbatuar drejtë dispozitat e LPP-së, prandaj në vlerësim të kolegjit të këshillit sa i përket këtij procesi nuk ishte konstatuar drejtë gjendja faktike nga se kjo mundësi ishte parashikuar në nenin 104 paragrafi 4 sa i përket çështjes së interesit publik, e që mbi këto arsye edhe pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji i këshillit sa i përket pretendimeve për shkelje të dispozitave materiale konstaton se është fakt i pamohueshëm nga palët në procedurë se AK ende pa marrë vendimin nga OSHP-ja, vetëm bazuar në vlerësimin e Ekspertit Shqyrtues, kishte ndërmarrë veprimet në lidhje me vazhdimin e procedurës së rivlerësimit, ndërsa pas kërkesës për rishqyrtim të vendimit nga pala ankuese pasi e njëjta kërkesë nuk ishte marrë parasysh nga AK dhe pas kësaj faze përkundër që pala ankuese kishte të drejtë ankese në afatin ligjor prej 10 ditësh ndaj këtij procesi

në OSHP, por që nuk kishte ushtruar ankesë e që pastaj ka rezultuar me nënshkrim të kontratës, e që praktikisht nënkupton se ky proces i rivlerësimit është konsideruar i drejtë edhe nga pala ankuese në këtë procese, pasi ishte edhe kërkesë specifike e palës ankuese në fazën e parë të këtij aktiviteti të prokurimit, dhe se poashtu kjo mundësi parashihej edhe në dispozitat e LPP-së përkatësisht nenin 115 paragrafi 3 ku parashihej: "3. Nëse, në vendimin e tij, autoriteti kontraktues konstaton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme, dhe ankuesi nuk ka refuzuar, ai brenda pesë (5) ditëve, apo afatit të lejuar nga eksperti, do të ndërmerr çfarëdo veprimi korrigjues të rekomanduar nga eksperti për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj dhe të mënjanojë atë që është e mundur çdo dëm ose kërcënim që shkon në dëm të parashtruesit të ankesës ose operatorëve të tjerë ekonomik", por që KRPP-ja në këtë rast nuk kishte marrë për bazë këtë veprim të ankuesit që ishte i bazuar në dispozitën e lartshënuar, përkundër që e kishte konfirmuar në këtë vendim të atakuar se në fazën e rivlerësimit është vepruar në harmoni me legjislacionin në fuqi të prokurimit publik, e gjithashtu nga shkresat e lëndës përkatësisht vendimi i atakuar nga KRPP-ja nuk është marrë për bazë edhe fakti se OSHP-ja në rastin konkretë sa i përket vendimmarrjes në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik që ka atakuar këtë proces është jashtë afatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L/237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, nga se ankesa nga operatori ekonomik "E..Shpk"-F., në OSHP ishte parashtruar më datë 19.10.2022 ndërsa OSHP-ja vendimin e kishte marrë më datë 23.01.2023.

Kolegji i këshillit nga shkresat e bashkangjitura e posaçërisht përmbajtjes së pjesës hyrëse të vendimit të atakuar sa i përket objektit të kësaj ankese konstaton se në ligjin Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L/237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 (LPP), neni 25 paragrafi 8 i referohet anulimit të certifikatës së prokurimit por jo edhe pezullimit të së njëjtës, dhe se poashtu në rast se nëpunësi civil në vazhdim qoftë nëse nuk i plotëson kushtet për të mbajtur më tutje licencën, qoftë për shkak të konstatimit të ndonjë shkelje të rëndë të legjislacionit të prokurimit publik, procesi i anulimit të certifikatës duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil, për të argumentuar këtë çështje më poshtë po e pasqyrojmë nenin 25 paragrafi 8 i cili parasheh: "8. Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil.....".

Kolegji i këshillit, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese dhe me rastin e vendimmarrjes si në dispozitiv të këtij vendimi, mori për bazë edhe kërkesën e datës 24 Gushtë 2022 të Anëtarit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik A.R, i cili ishte në cilësi të Kryetarit të Panelit Shqyrtues me rastin e ankesës që ndërlihet me këtë lëndë që është objekt i kësaj ankese, e cila përveç që nuk ishte e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës, nuk është potencuar përgjegjësia individuale e ankuesit në këtë proces, poashtu nga shkresat e lëndës të dërguara nga palët nuk kemi hasur në ndonjë autorizim të të njëjtit që në emër të OSHP-së, Panelit Shqyrtues, apo Titullarit të Institucionit-OSHP-së, të parashtrroj kërkesën për marrjen e masave ndaj ankuesit-Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit Publik të Komunës së Shtimes, e në mënyrë specifike kjo

kërkesë nuk është e bazuar në asnjë dispozitë ligjore që parasheh një veprim të tillë administrativ në lidhje me këtë çështje.

Kolegji i këshillit nga ajo që u tha si më lartë me rastin e vendim marrjes mori për bazë dispozitat e Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 24 paragrafin 3. "Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", nenin 45 sa i përket përgjegjësisë disiplinore si dhe paragrafet si në vijim "1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit". nenin 46 sa i përket konstatimit të shkeljeve disiplinore si dhe paragrafet si më poshtë "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimit", nenin 47 sa i përket llojeve të masave disiplinore si dhe paragrafet në vazhdim "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenin 48 sa i përket kompetencës dhe procedurës disiplinore si dhe paragrafeve në vijim "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor. 4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen

e një shkeljeje disiplinore. 5. Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. 6. Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate. 7. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati dyvjeçar (2) nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga Shërbimi Civil, afati është tetë (8) vjet. 8. Masat disiplinore regjistrohen në dosjen personale të nëpunësit. 9. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedurën e hollësishme disiplinore, në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative", nën 49 paragrafi 1 sa i përket themelimit të komisionit disiplinorë "1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse", dhe nën 50 sa i përket parimeve të individualizimit të masave disiplinore si dhe paragrafeve në vazhdim "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore".

Kolegji i këshillit bazuar në shkresat e lëndës konstaton se dispozitat e Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik ,i cili në mënyrë specifike rregullon të drejtat dhe përgjegjësit e nëpunësve civil duke përfshi edhe konstatimin e shkeljeve disiplinore, llojet e shkeljeve si dhe shqiptimin e masave adekuate konform shkeljeve, ndërsa institucionet publike që trajtojnë shkeljet eventuale disiplinore të nëpunësve civil duke përfshi edhe shqiptimin e masave disiplinore kanë obligim ligjor që shkeljet eventuale, konstatimin e tyre, llojet e shkeljeve dhe shqiptimin e masave disiplinore ta bëjnë konform dispozitave të këtij ligji-LZP-së, nga se sipas nenit 85 të këtij ligji parashihet : "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligji", andaj bazuar në këtë përcaktim ligjorë nga kolegji i këshillit konstatohet se në çdo rast të trajtimit përkatësisht konstatimit të shkeljeve disiplinore si dhe shqiptimit të masave disiplinore duhet të mbizotërojnë dispozitat e këtij ligji-LZP-së, ndërsa në rastin konkretë me rastin e konstatimit të shkeljeve dhe shqiptimin e masës përkatësisht pezullimit të certifikatës profesionale të prokurimit të ankuesit si rezultat i konstatimit të një shkelje të rëndë që është krye nga ankuesi-nëpunësi civil gjithnjë sipas pretendimit të organit që atakohet me këtë ankesë-KRPP-ja, bie ndeshë me dispozitat e këtij ligji, ndërsa nga ajo që u tha si më lartë me rastin e konstatimit të shkeljeve dhe shqiptimit të masave disiplinore ndaj nëpunësve civil patjetër duhet të

respektohen dispozitat e ligjit të zyrtarëve publik dhe vetëm pasi të respektohen këto dispozita dhe konstatohen shkeljet eventuale të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, nga organet e potencuara si më lartë të parapara në Ligjin e Zyrtarëve Publik, ndaj nëpunësve civil që kanë cenuar dispozitat e LPP-së mund të merren masa disiplinore konform shkeljeve që janë konstatuar ,andaj edhe pretendimi nga ankuesi për shkelje të dispozitave të Ligjit të Zyrtarëve Publik sa i përket këtij procesi administrativë që është objekt i kësaj ankese është i bazuar dhe duke konstatuar shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike si dhe shkelje të dispozitave materiale, ankesa është aprovuar dhe rrjedhimisht edhe anulohet vendimi i KRPP-së Nr.73/2023 i datës 24/08/2023 i nxjerrë nga Kryetari i Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik më datë 18.09.2023 i cili është atakuar përmes kësaj ankese, andaj edhe obligohet Kryetari i Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik që të veprojnë konform dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1168/2023, datë 14/11/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të Autorizuar të Ankuesit ,Avokatit
- Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik-KRPP;
- Kryetarit të Komunës së Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.